



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 255/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Nenad Laziç dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gani Mustafa, nga Mitrovica, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AKK-NISMA, dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla të ndriçimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 12.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Gani Mustafa, nga Mitrovica, Anr.255/2017, e datës 12.06.2017, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AKK-NISMA, dega në Mitrovicë.

### A r s y e t i m

PZAP-i, nëpërmjet Postës së Kosovës, ka pranuar një ankesë me datë 12 qershor 2017, nga Gani Mustafa, nga Mitrovica, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AKK-NISMA, dega në Mitrovicë, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se me datën 04.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka vendosur flamuj në shtyllat e ndriçimit publik në Qendër të Mitrovicës, duke theksuar se kjo përbën shkelje ligjore. Në cilësinë e provës parashtruesi ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Parashtruesi i ankesës pretendon se koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke vendosur flamuj në shtylla të ndriçimit publik, në Qendër të qytetit në Mitrovicë.

Paneli, vlerësoi se pretendimet në ankesë janë të paqëndrueshme për faktin se nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se flamujt e cilit subjekt politik janë të vendosur në shtylla publike. Andaj duke nisur kjo se dëshmitë e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk janë bindëse dhe të qarta siç kërkohen me nenin 117 par. 3 të

LZP-së, paneli nuk ka mund të vërtetoi se ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike mbështetësit dhe kandidatët, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Duke u nisur nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 255/2017 i datës 12.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**

Adnan Konushovci

***Këshillë Juridike :***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 i LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*